

PËRMBLEDHJE INFORMATIVE

Taksimi i ulët i duhanit në kohë inflacioni të lartë: Pse duhani është bërë më i lirë në Shqipëri

Hyrja

Prevalenca e duhanpirjes në Shqipëri mbetet e lartë - pothuajse gjysma e meshkujve konsumojnë duhan. Niveli i konsumit të duhanit në Shqipëri tejkalon ndjeshëm nivelet e konsumit të duhanit në vendet e OECD-së si edhe nivelin mesatar globale. Prevalenca është edhe më e lartë tek **të rinjtë e moshës 25 deri në 34 vjeç (rreth gjysma e tyre pinë duhan)** - shumica e duhanpirësve kanë filluar konsumin e rregullt të duhanit para moshës 18 vjeç (DSA, 2019).

Pirja e duhanit është një faktor rreziku kryesor për shumicën e sëmundjeve kryesore jo të transmetueshme (përfshirë kanceret e ndryshme, sëmundjet kardiovaskulare, diabetin dhe sëmundjet e mushkërive) dhe është shkaku kryesor i parandalueshëm i vdekjeve të parakohshme në të gjithë botën, përfshirë Shqipërinë. **Mijëra shqiptarë vdesin çdo vit për shkak të konsumit të duhanit.**

Konsumi i duhanit përbën një barrë të konsiderueshme ekonomike për shoqërinë, duke ndikuar si duhanpirësit ashtu edhe individë joduhani të ekspozuar ndaj tymit/konsumit të duhanit. Sëmundjet që lindin nga konsumi i duhanit kontribuojnë në rritjen e përdorimit të shërbimeve të kujdesit shëndetësor dhe në kostot përkatëse. Për më tepër, konsumi i duhanit shkakton/sjell ulje të produktivitetit (në punë). Në Shqipëri, llogaritet se shpenzimet vjetore të kujdesit shëndetësor të shkaktuara nga konsumi i duhanit dhe që mbulohen nga familjet arrijnë në rreth 223 milionë lekë, me pjesën më të madhe të alokuar për shpenzimet e lidhura me ilacet. Gjithashtu, kostot e përgjithshme vjetore që i atribuohen duhanpirjes në kuadrin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor (FSDKSH) vlerësohen të jenë 11.2 miliardë lekë (Merkaj et al., 2023b).

Përdorimi i duhanit zvogëlon pjesën e të ardhurave të disponueshme për të përmbushur nevojat bazë të familjeve si kujdesi shëndetësor dhe arsimit, veçanërisht për familjet me të ardhura të ulëta. Efekti varfëruës i pirjes reflektohet në faktin që rreth 13,000 familje me 60,000 anëtarë, duke përfshirë më shumë se 10,000 fëmijë, kanë kaluar nën kufirin e varfërisë - pra pirja e duhanit çon në thellimin e varfërisë (Merkaj et al., 2023b).

Në këtë kontekst, ulja e konsumit të duhanit duhet të konsiderohet si një prioritet kryesor i politikës për të përmirësuar situatën shëndetësore dhe situatën për familjet e prekura dhe shoqërinë në tërësi. **Politikat fiskale - veçanërisht nivelet më të larta të akcizës për produktet e duhanit - konsiderohen gjerësisht si politikat më efektive për të frenuar konsumin e duhanit.** Nëse nivelet e taksimit për duhanin nuk tejkalojnë nivelet e larta aktuale të inflacionit, produktet e duhanit do të bëhen relativisht më të lira (në krahasim me mallrat e tjera) ndërkohë që efekti negativ mund të reflektohet edhe në të ardhurat nga taksat.

Faktorët që përcaktojnë konsumin e duhanit


Një nga shkaqet kryesore të niveleve të larta të konsumit të duhanit në Shqipëri janë **çmimet relativisht të ulëta të cigareve**. Çmimet e cigareve janë relativisht të ulëta në Shqipëri pjesërisht për shkak të akcizës së ulët për produktet e duhanit. Nivelet e akcizës të duhanit janë ndër më të ulëtat në rajon dhe ndjeshëm më e ulët në krahasim me kërkesat minimale të BE-së.

Studimet e mëparshme në Shqipëri tregojnë se **çmimi ka një ndikim të madh në gjasat për të filluar duhanin si dhe në vendimin për të lënë duhanin**. Një rritje prej 10 për qind e çmimit ul mundësinë e fillimit të pirjes së duhanit në Shqipëri me më shumë se pesë për qind (Gjika et al., 2020). **Çmimi ka një ndikim veçanërisht të fortë në gjasat për fillimin e pirjes së duhanit nga të miturit në Shqipëri** (Merkaj et al., 2023a). Kështu, rritja e taksave që reflektohet në rritjen e çmimeve të cigareve kontribuojnë në uljen e konsumit të duhanit. Rritja e taksave mund të jetë edhe më efektive kur kombinohet me rritjen e ndërgjegjësimit, përmirësimin dhe zbatimin e legjislacionit në lidhje me kontrollin jo-fiskal të duhanit, si dhe ndalimin e pirjes së duhanit në vende publike.

Tendencat e çmimeve të cigareve dhe duhanit

Nga dhjetori 2020 deri në nëntor 2023, çmimet e cigareve dhe duhanit u rritën me afro 12 për qind. Gjatë së njëjtës periudhë, niveli i përgjithshëm i çmimeve/inflacionit ishte 15 për qind dhe kostot e ushqimit u rritën me 28 për qind. **Rrjedhimisht, niveli i rritjes së çmimeve të ushqimeve ka qenë më shumë se dyfishi në krahasim me cigaret, duke i bërë cigaret shumë më “të lira”**.


Figura 1. IÇK dhe indekset e çmimeve sipas llojit të kategorisë së produktit (përqindje)



Burimi: Përpunimi i autorëve bazuar në të dhënat e INSTAT (2023).

Nëse llogarisim raportin e indeksit të çmimeve të ushqimeve me indeksit e çmimeve të duhanit dhe cigareve, rezulton që duhani dhe cigaret janë bërë **13–17 për qind më të lira krahasuar me ushqimet** që nga dhjetori 2020.

Figura 2. Raporti i indekseve/niveleve të çmimeve të duhanit dhe cigareve ndaj ushqimit



Burimi: Përpunimi i autorëve bazuar në të dhënat e INSTAT (2023).

Politikat e kontrollit të duhanit dhe efektet e tyre mund të vlerësohen më së miri nëse krahasohen me vende të ngjashme. Kur shqyrtojmë kostot e cigareve midis 2016 dhe 2022 në krahasim me vende të tjera të Ballkanit Perëndimor, sipas të dhënave të EUROSTAT (2023) **Shqipëria ka përjetuar ritmin më të ngadaltë të rritjes së çmimit të cigareve, çka reflekton taksimin më të ulët.**

Konkluzione dhe Rekomandime

Rritja e taksimit është ndër strategjitë më efektive për uljen e konsumit të duhanit dhe dëmeve shëndetësore dhe ekonomike që lidhen me të, jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë botën. **Rritja e akcizës së duhanit në Shqipëri pritet të ulë numrin e vdekjeve të parakohshme (mijëra cdo vit).** Gjithashtu, rritja e akcizës ka një efekt pro të varfërve, pasi familjet me të ardhura më të ulëta shfaqin ndjeshmëri më të madhe ndaj ndryshimeve të çmimeve dhe rrjedhimisht kanë më shumë gjasa të lënë duhanin - ose të mos e fillojnë – si rrjedhojë e çmimeve të larta. **Një reduktim i konsumit të duhanit në familjet me të ardhura më të ulëta nënkupton një ulje të varfërisë dhe rritje të shpenzimeve për arsim dhe shëndetësi.** Rrjedhimisht, familjet me të ardhura më të ulëta do të përfitojnë më shumë nga ulja e konsumit të duhanit. Veçanërisht duke pasur parasysh statusin e Shqipërisë si një nga vendet më të varfra në Evropë, kjo nënkupton një reduktim të pabarazive të vazhdueshme ekonomike të shkaktuara nga përdorimi i duhanit (Gjika et al., 2020; Merkaj et al., 2023).

Për më tepër, gjetjet tregojnë se **taksat më të larta që çojnë në rritjen e çmimeve të cigareve janë veçanërisht efektive në uljen e gjasave për pirjen e duhanit tek të rinjtë.** Ky efektivitet i atribuohet kushteve specifike socio-ekonomike të kësaj grupmoshe. Të rinjtë dhe të miturit janë më të ndjeshëm ndaj ndryshimeve të çmimit të cigareve në krahasim me të rriturit, për shkak të kufizimeve më të mëdha buxhetore. Gjithashtu, të rinjtë/miturit priren të kenë nivele më të ulëta të varësisë ndaj duhanit, duke pasur parasysh periudhën më të shkurtër të duhanpirjes (që ndikon të varësia), ndaj efektiviteti i rritjes së taksimit është më i lartë për këtë kategori (Merkaj et al., 2022).

Gjetjet e studimit tregojnë urgjencën e zbatimit të politikave që synojnë reduktimin e konsumit të duhanit duke e bërë duhanin më pak të përballueshëm. **Duhet të merren masa urgjente për të kompensuar tendencën e fundit të uljes së çmimeve relative të duhanit, që vjen nga fakti se akciza nuk reflekton tendencat e inflacionit, e cila bëhet më e dukshme në kohë inflacioni të lartë.**

Mirënjohje

Development Solutions Associates (DSA) është angazhuar në kuadrin e programit Tobacconomics në bashkëpunim me Universitetin Johns Hopkins (JHU) (më parë me Universitetin e Illinois Chicago (UIC)) për të kryer hulumtime ekonomike mbi taksimin e duhanit në Shqipëri. JHU është një partner i Iniciativës Bloomberg për Reduktimin e Përdorimit të Duhanit. Pikëpamjet e shprehura në këtë dokument nuk mund t'i atribuohen dhe as nuk përfaqësojnë pikëpamjet e JHU, UIC ose Bloomberg Philanthropies. Autorët i janë mirënjohës për mbështetjen ekipit të DSA-së, veçanërisht, Dr. Edvin Zhllima, Dr. Aurora Hoxha dhe znj. Alba Tema, dhe ekipit të JHU dhe UIC, veçanërisht Dr. Jeffrey Drope.

Sugjerohet të citohet si:

Imami, D., & Merkaj, E. (2024). *Taksimi i ulët i duhanit në kohë inflacioni të lartë: Pse duhani është bërë më i lirë në Shqipëri*. Development Solutions Associates.

Referencat

DSA (2019) Survey on Tobacco Consumption in SEE Countries (STC-SEE)

EUROSTAT. (2023). *Price indexes database*. <https://ec.europa.eu/eurostat/web/main/data>

Gjika, A., Zhllima, E., Rama, K., & Imami, D. (2020). Analysis of tobacco price elasticity in Albania using household level data. *International Journal of Environmental Research and Public Health*, 17(2), 432.

INSTAT. (2023). *Price indexes database*.

<https://www.instat.gov.al/al/temat/%C3%A7mimet/indeksi-i-%C3%A7mimeve-t%C3%AB-konsumit/>

Goodchild, M., Nargis, N., & d'Espaignet, E. T. (2018). Global economic cost of smoking-attributable diseases. *Tobacco Control*, 27(1), 58-64.

Merkaj, E., Zhllima, E., Imami, D., Gjika, I., Manuel, C., & Guerrero-López, J. D. (2022). *Impact of cigarette prices and tobacco control policies on smoking onset among young people in Albania*. Tobacconomics Working Paper No. 22/9/1. University of Illinois, Chicago.

Merkaj, E., Imami, D., & Zhllima, E. (2023a). *The impoverishing effect of tobacco use in Albania* [Working Paper Series]. DSA. <https://www.tobacconomics.org/research/the-impoverishing-effect-of-tobacco-use-in-albania-working-paper-series/>

Merkaj, E., Hoxha, A., & Imami, D. (2023b). *The health costs of smoking in Albania*. Technical Report. Development Solutions Associates.